

PER PRINDERIT E FEMIJEVE TE SHKOLLES

“ CARLO COLLODI”

Për të garantuar zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe nje shërbim korrekt kundrejt fëmijëve për të mirën e gjithë komunitetit ofrojmë informacionet dhe udhëzimet e mëposhtme

ORARI

Shkolla është e hapur nga e hëna deri të premten në oraret si më poshtë:

Hyrja	ora 8.00/9.15
Dalja përpara drekës	ora 11.30/11.45
Dalja mbas drekës	ora 13.00/13.30
Dalja me autobus	ora 15.00
Dalja	ora 15.30/16.00

Ju luetmi të respektoni të gjitha oraret në mënyrë që të mos pengoni zhvillimin e rregullt të aktiviteteve. Nëse nuk do të rrespektohen oraret, vonesat në hyrje dhe në dalje do të sinjalizohen nga ana e mësuesëve tek Drejtori i Shkollës.

Për të komunikuar me mësueset në rast nevojë o urgjence mund të telefononi tek:

Kopshti “Carlo Collodi” : 0422/912054

Për t’ju përmbajtur rregullave në lidhje me Covid -19, theksojmë sa më poshtë:

- Vetëm një prind (apo një i rritur i autorizur nga prindi) mund të shoqërojë gjithmonë fëmijën në hyrje të shkollës. Temperatura duhet të jetë matur përpara se ta shoqëroni në shkollë. Fëmijën do tja dorëzoni personalisht mësuesit përkatës ose bashkëpuntorit shkollor
- Fëmijët e ri të sapo rregjistruar (edhe ata që vijnë me autobuzin shkollor) duhet të shoqërohen nga prindërit ditët e para të shkollës në mënyrë që të shkëmbejnë informacionet e duhura dhe të bien dakord me mësueset për pranimin gradual në jetën shkollore të fëmijëve (Projekti Mirëpritjes)
- Prindërve të fëmijëve të rinj, për të bërë të mundur qëndrimin në shkollë, do tu matet temperatura dhe duhet të përpilojnë një autodeklaratë si vizitues.

- Në dalje fëmija do ti dorëzohet prindit ose shoqëruesit në moshë madhore që është autorizuar nga vetë prindi (pasi do ketë paraqitur modularin përkatës)
- Ndalohet qëndrimi në ambientet e shkollës përtej orës së nevojshme
- Rregullorja e shkollës neni 16 në pikën 16.5. Largim parandalues nga Shkolla(kopësht, fillorja dhe tetvjecarja) me tërheqje nga ana e prindit në rastet si më poshtë:
 - a) Temperature ose mos ndjerje mirë
 - b) Diarre dhe të vjella
 - c) Skuqje e syve si pasojë e konxhantivitit (për tu kthyer në shkollë nevojitet certifikata e mjekut)
 - d) Prani thërrije, morra apo parazitë të tjerë nëse parashikohen nga protokollu ULSS
 - e) Nëse fëmijët komunikojnë që ndjehen shumë keq
 - f) Irritim lëkure dhe dyshim për sëmundje infektive

Nëse fëmija kthehet në shkollë pas 5 ditë mungesash, përfshirë këtu edhe të shtunën e të djelën, duhet të paraqesi certifikatë nga mjeku.

- Ju lutemi komunikoni komunikoni mungesën brenda ditës
- Sipas rregullores së shkollës, neni 16, për mungesat mbi 30 ditë, për arsye shëndetsore, është e nevojshme certifikata e mjekut për ruajtjen e vendit. Mungesat pa arsye shëndetsore duhet të sinjalizohen para kohe Drejtorit Shkollor, edhe nëpërmjet mësuesve, i cili do të kryej verifikimet sipas kompetencave.
- Nga fillimi i vitit shkollor mungesat pa arsye që kapërcejnë 12 ditë dhe që nuk janë senjalizuar duhet të komunikohen në përshtetshmëri me nxënësit
- Nxënësit NUK mund të sjellin ILACE në shkollë neni 24 i rregullores së shkollës

Ju këshillojmë të konsultoni ndryshimet dhe rifreskimet e Rregullores së Istituit në lidhje me normat e Covid-19 të publikuara në faqen e internetit dhe të udhëzimeve rajonale për rihapjen e shërbimeve për moshën 0-6 vjeç të Rajonit Veneto që gjenden në faqen e Rajonit.

UDHEZIME TE VECANTA

Fëmijët duhet të vishen me rroba praktike e te rehatëshme në mënyrë që të jenë të lirë dhe autonom. Këshillohet përdotimi i një përplasjeje për aktivitetet, nuk ka rëndësi ngjyra. Është e domodoshme që cdo fëmijë të ketë një palë ndërresa (mbathje, bluzë, corape, pantallona...) dhe tek të gjitha të jetë shënuar emri dhe mbiemri.

Për shkak të emergjencës sanitare nuk mund të përdoren më grykore apo peshqir personal për kto nevoja do ti ofrojë vetë shkolla mjetet e nevojshme. Nuk lejohet të sillen nga shpia asnjë lloj sendi personal (lodra etj..)

MENSA

Mensa është kompetencë e Bashkisë. Gjatë orarit të mensës mësuesit ofrojnë shërbim asistence dhe edukimi.

NDIHMA E SHPEJTE DHE DHENIA E ILACEVE

Shkolla është e pajisur me një PLAN TE NDERHYRJE SE SHPEJTE ku caktohen mënyrat e ndërhyrjes dhe të organizimit në raste dëmtimi apo keqndjerje ashtu si edhe detyrat e rolet e figurave të përcaktuara për kryerjen e ktyre detyrave dhe burimet e nevojshme.

Mësuesit nuk e kanë për detyrë dhënien e ilaceve. Për dhënien e ilaceve “salvavita” shpëtuese jete duhet dërguar kërkesa nga ana e familjeve në drejtori.

Shkolla gjithashtu është e pajisur me një PLAN ZBRAZJE dhe cdo vit bëhen 2 deri në 3 simulime zbrazjeje të ndërtesës së shkollës.

GREVA DHE MBLEDHJE TE PERSONELIT

Shpërndarja e lajmërimeve në lidhje me grevat apo mbledhjet në orar shkollor do të kryhet në mënyrë që të firmosen në kohë nga prindërit. Prindërit e fëmijëve që vijnë në shkollë me autobuzin shkollor në raste greve apo mbledhjeje duhet ti përcjellin vetë fëmijët në shkollë për tu siguruar nëse mësimi do vazhdojë apo do të bëhet grevë ose mbledhje .

GJATE VITIT SHKOLLOR PARASHIKOHEN MBLEDHJE ME PRINDERIT DHE TAKIME PER TE PARAQITUR AKTIVITETET E PROGRAMUARA DHE PER TE DHENE INFORMACIONE TE DOBISHME NE LIDHJE ME DETYRAT DHE TE DREJTAT E NXENESVE, TE PUNONJESVE DHE FAMILJEVE. NE FAQEN E INSITUTIT GJENI TE GJITHA TE DHENAT PER PTOF-in www.icvillorbapovegliano.edu.it

* “ Shkolla ka si objektiv ndërtimin e aleancës me prindërit. Bëhet fjalë për një marrëdhënie jo vetëm në castet kritike por për bashkëpunim të vazhdueshëm ku njihen dhe rrespektohen rrolet reciproke në mbështetje të njëri-tjetrit duke pasur si qëllim të përbashkët edukimin e fëmijëve”

RREGULLORJA ka si qëllim integrimin e një stili edukues të përbashkët. Shkollë të Mbarë!

MESUESIT

DREJTORI SHKOLLOR